



01 Nr. 565/24 Dt. 20.09.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e dytë (kësti II) për sigurimin e hapësirës për pjesëmarrjen e Komunës së Prizrenit-Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Panairin "Global Albanian Gastronomy Festival", që organizohet (mbahet) në Berlin të Republikës së Gjermanisë nga data 02 tetor 2024 deri me 03 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 4.470,95 € (katërmijë e katërqind e shtatëdhjetë euro e nëntëdhjetë e pesë cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

